

URDHËR
Nr. 449, datë 31.12.2020

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË BORDIT DISIPLINOR TË DHOMËS
KOMBËTARE TË NOTERËVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të shkronjës "a", të pikës 1 dhe të pikës 2, të nenit 42, të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë", si dhe të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 169, datë 10.6.2020, "Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor",

KONSTATOJ:

Në zbatim të kërkesës për shprehje të interesit të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, nr. 6547, datë 19.10.2020, janë paraqitur kandidaturat të cilat kanë shprehur interes për t'u zgjedhur si anëtar i Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë, në referim të pikës 1, të nenit 42, të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë", ku 2 anëtarë zgjidhen nga ministri i Drejtësisë.

Në zbatim të urdhrit nr. 369, datë 6.11.2020, "Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë", është vijuar me trajtimin e kandidaturave të paraqitura dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore.

Dokumentacioni i paraqitur nga znj. Entela Memishaj Shehaj është protokolluar nga Ministria e Drejtësisë me nr. E-195 prot., datë 2.11.2020, i cili është dërguar brenda afatit ligjor të përcaktuar në shprehjen e interesit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton, se kërkuesja, përveç eksperiencës së gjatë si avokate, kryesisht në fushën e së drejtës tregtare, atë të korporatave, çështje të cilat kanë të bëjnë me të drejtën e pasurive të paluajtshme, të drejtën bankare, markat, si dhe të drejtën e pronësisë intelektuale, të cilat janë aspekte që lidhen ngushtësisht me veprimtarinë që kryejnë noterët publikë, ka realizuar edhe disa botime shkencore dhe, për rrjedhojë, kërkuesja plotëson kriteret e parashikuara nga neni 42, pika 2, i ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë".

Bazuar në eksperiencën e provuar shkencore dhe profesionale në çështjet e së drejtës civile, si dhe meritat profesionale të kërkueses,

URDHËROJ:

1. Zgjedhjen e znj. Entela Memishaj Shehaj, si anëtare të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

2. Mandati si anëtare e Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë, fillon në datën 1.1.2021 dhe përfundon në datën 31.12.2026.

3. Subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim administrativ pranë ministrit të Drejtësisë, brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit, sipas pikës 11 të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 169, datë 10.6.2020, "Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterëve", të ndryshuar.

4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave dhe njoftimin e këtij urdhri, znj. Entela Memishaj Shehaj, Dhomës Kombëtare të Noterisë, si dhe Shkollës së Magjistraturës.

5. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)